

*Përgjegjës/Spektori i Statistikës, Modeleve dhe Analizës së Indikatorëve, Drejtoria e Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.*

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik" i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 233, datë 20.12.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës/ Spektori i Statistikës, Modeleve dhe Analizës së Indikatorëve, Drejtoria e Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

- Drejton të gjithë punën e sektorit dhe përgjigjet për cilësinë e saj pranë drejtorit të drejtorisë;
- Analizon indikatorët e sigurisë kibernetike, me qëllim identifikimin e trendeve, modeleve dhe kërcënimeve potenciale kibernetike;
- Përpunon dhe administron të dhënat statistikore sipas funksioneve të Autoritetit;
- Zhvillon dhe implementon modele efektive për shpërndarjen e informacioneve mbi praktikën më të mira të sigurisë kibernetike, në harmonizim me praktikën ndërkombëtare të fushës;
- Përshtat dhe publikon zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë kibernetike, në kanalet zyrtare të Autoritetit;
- Analizon modelet dhe indikatorët e sigurisë kibernetike, për të identifikuar kërcënimet potenciale dhe rrezikun për sistemet kibernetike;
- Adreson nevojat për zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe trajnimeve përkatëse sipas sektorëve;
- Merr pjesë në grupet e punës për rritjen e kapaciteteve, që zhvillon Autoriteti me operatorët e infrastrukturave të informacionit dhe institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes;
- Ndërvepron me sektorët e tjerë brenda Autoritetit për mbarëvajtjen e punës;
- Ndan dhe monitoron detyrat dhe përgjegjësitë ndërmjet specialistëve të sektorit;
- Monitoron punën e punonjësve në varësi dhe zbaton sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës për ta;
- Merr pjesë në grupe të ndryshme pune, komisione, konferenca kombëtare e ndërkombëtare duke përfaqësuar Autoritetin.

## **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

**Arsimi:** Niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Inxhinieri Elektrike/Shkenca Kompjuterike/ Shkenca Teknologjike/Shkenca Shoqërore.

**Përvoja:** Të paktën 2 vite përvojë pune.

### **FUSHA E NJOHURIVE:**

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Legjislacionin e sigurisë kibernetike;
- Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale.

Aftësi për të:

- Identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale; Koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve;
- Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja.
- Aftësi shumë të mira në analizimin dhe zgjidhjen e problemeve në kohë reale;
- Aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup;
- Përbën avantazh pajisja me certifikata të fushës;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

### **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (III-1)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 10.01.2024, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: [burimet.njerezore@cesk.gov.al](mailto:burimet.njerezore@cesk.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell shkualifikim të kandidatit.